



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,  
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 19 dhjetor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit mbi  
Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve**

---

**Prokurores së Specializuar**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**

Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**

Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

## Tabela e përmbajtjes

|      |   |    |
|------|---|----|
| I.   | HISTORIKU PROCEDURAL .....                        | 2  |
| II.  | PARASHTRIME .....                                 | 3  |
| III. | DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE .....                | 7  |
| IV.  | DISKUTIM .....                                    | 8  |
| A.   | Pikat e Krasniqit .....                           | 8  |
| 1.   | Pika e Parë e Krasniqit .....                     | 8  |
| 2.   | Pika e Dytë e Krasniqit.....                      | 10 |
| 3.   | Pika e Tretë e Krasniqit .....                    | 12 |
| 4.   | Pika e Katërt dhe Pika e Pestë e Krasniqit .....  | 14 |
| 5.   | Pika e Gjashtë dhe Pika e Shtatë e Krasniqit..... | 16 |
| 6.   | Pika e Tetë e Krasniqit.....                      | 18 |
| 7.   | Pika e Nëntë e Krasniqit .....                    | 21 |
| B.   | Pikat e Veselit.....                              | 23 |
| 1.   | Pika e Parë e Veselit.....                        | 23 |
| 2.   | Pika e Dytë e Veselit .....                       | 25 |
| C.   | Pikat e Selimit .....                             | 27 |
| 1.   | Pika e Parë e Selimit .....                       | 27 |
| 2.   | Pika e Dytë e Selimit.....                        | 29 |
| 3.   | Pika e Tretë e Selimit .....                      | 30 |
| 4.   | Pika e Katërt e Selimit .....                     | 32 |
| 5.   | Pika e Pestë e Selimit .....                      | 34 |
| 6.   | Pika e Gjashtë e Selimit.....                     | 36 |
| V.   | KLASIFIKIMI.....                                  | 38 |
| VI.  | VENDIM.....                                       | 38 |

**TRUPI GJYKUES II** (“Trupi Gjykses”), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 9 nëntor 2023, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>1</sup>

2. Më 13 nëntor 2023, Trupi Gjykses miratoi zgjatjen e afatit për dorëzimin prej Mbrojtjes të kërkesave për leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar, duke caktuar si afat për dorëzimin e tyre datën 27 nëntor 2023.<sup>2</sup>

3. Më 27 nëntor 2023, ekipet e Mbrojtjes të z. Krasniqi (“Mbrojtja e Krasniqit”), z. Veseli (“Mbrojtja e Veselit”) dhe z. Selimi (“Mbrojtja e Selimit”) (bashkërisht “Mbrojtja”), dorëzuan kërkesat për leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar (përkatësisht, “Kërkesa e Krasniqit”, “Kërkesa e Veselit” dhe “Kërkesa e Selimit”; bashkërisht, “Kërkesat e Mbrojtjes”).<sup>3</sup> Mbrojtja e z. Thaçi nuk bëri kërkesë për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar.

4. Më 7 dhjetor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi një përgjigje përmbledhëse ndaj Kërkesave të Mbrojtjes (“Përgjigjja e ZPS-së”).<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> F01917, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 9 nëntor 2023.

<sup>2</sup> Transkripti i seancës, 13 nëntor 2023, p. 9823-9824, 9881.

<sup>3</sup> F01961, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 27 nëntor 2023; F01964, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 27 nëntor 2023; F01966, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 27 nëntor 2023.

<sup>4</sup> F01990, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kërkesave të Veselit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F01917*, 7 dhjetor 2023.

5. Më 15 dhjetor 2023, Mbrojtja dorëzoi kundërpërgjigjet ndaj Përgjigjes (përkatësisht, “Kundërpërgjigjja e Krasniqit”, Kundërpërgjigjja e Veselit” dhe “Kundërpërgjigjja e Selimit”).<sup>5</sup>

## II. PARASHTRIME

6. Mbrojtja e Krasniqit kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar në lidhje me pikat e mëposhtme (bashkërisht, “Pikat e Krasniqit”):

- 1) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe/ose juridik që konstatoi se pranimi i deklaratës së z. Krasniqi të majit 2007 të dhënë si dëshmitar për TPNJ-në, i dëshmisë së shkurtit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së dhe i dëshmisë së majit 2007 për TPNJ-në (“provat e z. Krasniqi për TPNJ-në”), të cilat u dhanë në mungesë të informimit të tij për të drejtën për mosinkriminimin e vetes apo të garancive të tjera mbrojtëse, nuk shkeli të drejtën e z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes (“Pika e Parë e Krasniqit”);
- 2) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik që zbatoi standardin e “pandershmërisë” ose “paarsyeshmërisë” kur shqyrtoi nëse z. Krasniqi kishte të drejtën e statusit të personit të dyshuar në kohën kur dha deklaratat dhe dëshmi për TPNJ-në (“Pika e Dytë e Krasniqit”);
- 3) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe/ose juridik që konstatoi se z. Krasniqi nuk kishte të drejtën e garancive që i jepen personit të dyshuar në kohën e dhënies së provave për TPNJ-në, përfshirë të drejtën për t’u informuar për privilegjin kundër vetinkriminimit, të drejtën për mbrojtës dhe të drejtën për të heshtur (“Pika e Tretë e Krasniqit”);
- 4) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe/ose faktik që konstatoi se nuk ka dallim thelbësor midis garancive mbrojtëse që iu ofruan dëshmitarëve sipas sistemit të TPNJ-së dhe atyre sipas kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara (“DHS”), duke shpërfillur për rrjedhojë faktin se, ndryshe nga Rregullorja e TPNJ-së, rregullat 41(1)(a) dhe (2) dhe 151 të Rregullores së DHSK-së kërkojnë që dëshmitarët të

---

<sup>5</sup> F02009, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Kërkesave të Veselit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F01917 (F01990)*, 15 dhjetor 2023, konfidencial; F02010, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Kërkesave të Veselit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F01917*, 15 dhjetor 2023; F02015, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Kërkesave të Veselit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F01917*, 15 dhjetor 2023.

informohen për të drejtën e mosinkriminimit të vetes përpara se të japin dëshmitë apo deklaratat e tyre (“Pika e Katërt e Krasniqit”);

- 5) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe/ose faktik që e arsyetoi pranimin e dëshmimeve të z. Krasniqi për TPNJ-në mbi bazën se ato ishin në përputhje me kornizën ligjore të TPNJ-së, duke zbatuar në këtë mënyrë standardin e një institucioni tjetër në vend të atij të DHS-së dhe duke mos trajtuar aspektin nëse fakti që z. Krasniqi nuk u informua për të drejtën e mosinkriminimit të vetes përpara se të jepte dëshmi përbënte mospërmbyshje të garancive minimale të parapara për dëshmitarët në DHS (“Pika e Pestë e Krasniqit”);
- 6) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe/ose faktik që konstatoi se, pavarësisht mungesës së informimit për të drejtën për mosinkriminimin e vetes, fakti që z. Krasniqi u paralajmërua se kishte detyrimin të tregonte të vërtetën dhe bëri betimin përkatës “nuk e detyroi [atë] të hiqte dorë nga e drejta për mosinkriminimin e vetes” (“Pika e Gjashtë e Krasniqit”);
- 7) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe/ose faktik që konstatoi se urdhërparaqitja në bazë të së cilës z. Krasniqi u detyrua të dëshmonte nuk e kufizoi të drejtën e tij për mosinkriminimin e vetes dhe se, për rrjedhojë, dëshmia e z. Krasniqi u dha vullnetarisht dhe pa shtrëngim/detyrim (“Pika e Shtatë e Krasniqit”);
- 8) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe/ose faktik që konstatoi se garancitë mbrojtëse të rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së nuk përfshijnë ndjekjet penale në DHS, duke e bërë të paefektshme një të drejtë themelore të mbrojtur nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”) (“Pika e Tetë e Krasniqit”); dhe
- 9) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik që pranoi si prova deklaratat dhe dëshmitë e të bashkakuarve kundër z. Krasniqi dhe konstatoi se dëmi i shkaktuar nga pamundësia e z. Krasniqi për t’u bërë pyetje atyre në cilësinë e palës kundërshtare nuk zhbënte vlerën provuese të provave (“Pika e Nëntë e Krasniqit”).<sup>6</sup>

7. Mbrojtja e Veselit kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar në lidhje me pikat e mëposhtme (bashkërisht, “Pikat e Veselit”):

- 1) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik në zbatimin e nenit 19(2) dhe rregullës 4(1), duke anashkaluar nenin 123 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (“KPPK”) pasi kishte konstatuar se pranueshmëria si

---

<sup>6</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 2, 23.

prova e deklaratave të të bashkakuarve nuk trajtohej specifikisht në kornizën ligjore të DHS-së (“Pika e Parë e Veselit”); dhe

- 2) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik që nuk zbatoi interpretimin më të favorshëm për të akuzuarin sipas rregullave 4(3) dhe 5 të Rregullores (“Pika e Dytë e Veselit”).<sup>7</sup>

8. Mbrojtja e Selimit kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar në lidhje me pikat e mëposhtme (bashkërisht, “Pikat e Selimit”):

- 1) Nëse Trupi Gjykses gaboi që pranoi si prova pjesë të intervistës së z. Selimi me ZPS-në, megjithëse konstatoi se z. Selimi nuk ishte informuar për të drejtën e tij për të prapësuar heqjen dorë nga përfaqësimi me mbrojtës gjatë atyre pjesëve të intervistës (“Pika e Parë e Selimit”);
- 2) Nëse Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se nuk kishte asnjë tregues se z. Selimi kishte qenë ndonjëherë i paqartë sa i takon statusit të tij si person i dyshuar (“Pika e Dytë e Selimit”);
- 3) Nëse Trupi Gjykses gaboi që pranoi si prova deklaratat dhe dëshminë e z. Selimi të dhëna si dëshmitar në shkelje të të drejtave të mëpasshme të z. Selimi si person i akuzuar (“Pika e Tretë e Selimit”);
- 4) Nëse Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh efektin dëmtues të shkaktuar nga pranimi i deklaratës si dëshmitar të z. Selimi për TPNJ-në të prillit 2004 dhe të dëshmisë së tij të majit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së (“provat e z. Selimi për TPNJ-në”), gjatë të cilave ai nuk u informua për të drejtën e mosinkriminimit e vetes (“Pika e Katërt e Selimit”);
- 5) Nëse Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se Kodi i Procedurës Penale të Kosovës nuk është i zbatueshëm në këtë proces gjyqësor (“Pika e Pestë e Selimit”); dhe
- 6) Nëse Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në aftësinë e Mbrojtjes për të kundërshtuar deklaratat e të akuzuarve apo në aftësinë e Trupit Gjykses për t’i vlerësuar ato në kuadër të tërësisë së provave, për të përlegjur pranimin e tyre (“Pika e Gjashtë e Selimit”).<sup>8</sup>

9. Mbrojtja parashtron se: (i) Pikat e Krasniqit, Pikat e Veselit dhe Pikat e Selimit (bashkërisht “pikat”), burojnë nga Vendimi, janë mjaftueshmërisht konkrete dhe të evidentueshme, dhe nuk përbëjnë thjesht mospajtime;<sup>9</sup> (ii) pikat ndikojnë në

---

<sup>7</sup> Kërkesa e Veselit, para. 2, 21.

<sup>8</sup> Kërkesa e Selimit, para. 1, 29.

<sup>9</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 4-15; Kërkesa e Veselit, para. 10-15; Kërkesa e Selimit, para. 2-21.

kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe në rezultatin e gjykimit;<sup>10</sup> dhe (iii) një vendim i menjëhershëm në lidhje me to nga Paneli i Gjykatës së Apelit do t'i kontribuonte thelbësisht procesit.<sup>11</sup>

10. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesat e Mbrojtjes duhet të rrëzohen pasi Mbrojtja nuk ka demonstruar se pikat meritojnë përdorimin e mjetit juridik të jashtëzakonshëm të apelit të ndërmjetëm.<sup>12</sup> ZPS-ja parashton se: (i) pikat nuk janë të apelueshme;<sup>13</sup> (ii) ato nuk do të kishin ndikim të ndjeshëm kryerjen e drejtë ose të shpejtë të procesit apo në rezultatin e gjykimit; dhe (iii) marrja në këtë fazë e një vendimi në lidhje me to në apel nuk do t'i kontribuonte thelbësisht procesit.<sup>14</sup> Në veçanti, ZPS-ja pretendon se një numër pikash për të cilat kërkohet leja për apel nuk burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar dhe se Mbrojtja keqinterpreton përmbajtjen e Vendimit të Kundërshtuar në lidhje me disa pika të tjera.<sup>15</sup>

11. Mbrojtja e Krasniqit kundërpërgjigjet se secila prej Pikave të Krasniqit përmbush kriteret e miratimit të lejes për apel sipas rregullës 77, pasi ato burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar, kanë të bëjnë me thelbin e të drejtës së të akuzuarit për mosinkriminimin e vetes, dhe ngrenë pyetje për pranueshmërinë e provave dhe, rrjedhimisht, ndikojnë në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.<sup>16</sup> Mbrojtja e Krasniqit parashton se në Përgjigjen e saj ZPS-ja keqinterpreton: (i) parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit; dhe (ii) standardin për miratimin e lejes për apel.<sup>17</sup> Mbrojtja e Krasniqit i kërkon me respekt Trupit Gjykses të rrëzojë kundërshtimet e ZPS-së dhe të miratojë lejen mbi bazën e Pikave të Krasniqit.<sup>18</sup>

---

<sup>10</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 4, 16-20; Kërkesa e Veselit, para. 10, 16-19; Kërkesa e Selimit, para. 2, 22-25.

<sup>11</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 4, 21-22; Kërkesa e Veselit, para. 10, 20; Kërkesa e Selimit, para. 2, 26-28.

<sup>12</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 1, 25.

<sup>13</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 2-22.

<sup>14</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 23-24.

<sup>15</sup> *Shih p.sh.* Përgjigjen e ZPS-së, para. 2, 4, 6, 10-11, 15, 18.

<sup>16</sup> Kundërpërgjigja e Krasniqit, para. 2.

<sup>17</sup> Kundërpërgjigja e Krasniqit, para. 3-4.

<sup>18</sup> Kundërpërgjigja e Krasniqit, para. 9.

12. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se Përgjigjja e ZPS-së duhet të mos merret parasysh dhe se duhet të miratohet leja për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar.<sup>19</sup>

13. Mbrojtja e Selimit kundërpërgjigjet se në Përgjigjen e saj ZPS-ja nuk u përgjigjet mjaftueshëm argumenteve të paraqitura nga Mbrojtja e Selimit lidhur me kriteret për leje për apel dhe as nuk trajton thelbin e pretendimeve të paraqitura.<sup>20</sup> Rrjedhimisht, Mbrojtja e Selimit parashtron se Përgjigjja e ZPS-së nuk duhet të merret parasysh prej Trupit Gjykses dhe se duhet të miratohet leja për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar.<sup>21</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

14. Sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse është përmbushur standardi për miratimin e lejes për apel i përcaktuar në këto dispozita.

15. Në rregullën 77(2) parashikohet se:

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohej dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund t'i kontribuojë thelbësisht procesit gjyqësor.

16. Trupi Gjykses përfshin përmes referimit dispozitat ligjore përkatëse mbi standardin ligjor për miratimin e lejes për apel, të paraqitura në vendimet e tij të mëparshme.<sup>22</sup>

---

<sup>19</sup> Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 5.

<sup>20</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 1. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 7-8.

<sup>21</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 1, 9.

<sup>22</sup> KSC-BC-2020-06, F01237, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8; KSC-BC-2020-07, F00423, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues* (Vendimi mbi Lejen për Apelim në Çështjen "Gucati dhe Haradinajt"), 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të Urdhrit F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00484, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për*

#### IV. DISKUTIM

##### A. PIKAT E KRASNIQIT

##### 1. Pika e Parë e Krasniqit

17. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se, duke hedhur poshtë argumentin e Mbrojtjes se pranimi i provave të z. Krasniqi për TPNJ-në në këtë proces gjyqësor do të shkelte të drejtën e tij për mosinkrimimin e vetes, Trupi Gjykes keqinterpretoi natyrën dhe kuadrin e së drejtës për mosinkrimimin e vetes.<sup>23</sup> Mbrojtja e Krasniqit parashtron se Pika e Parë e Krasniqit ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së z. Krasniqi për mosinkrimimin e vetes, që është komponent themelor i gjykimit të drejtë dhe, për rrjedhojë, ndikon në drejtësinë e përgjithshme të procesit dhe në rezultatin e gjykimit.<sup>24</sup> Mbrojtja e Krasniqit argumenton gjithashtu se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Parë të Krasniqit do t'i kontribuonte thelbësisht procesit sepse: (i) ofron siguri në lidhje me natyrën dhe kuadrin e së drejtës për mosinkrimim të vetvetes; (ii) qartëson standardin e zbatueshëm për përcaktimin se kur një individ ka të drejtën e statusit dhe të garancive të personit të dyshuar; (iii) shmang pranimin në dokumentacionin e çështjes të provave që janë në shkelje të të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë; dhe (iv) qartëson pozitën e dëshmitarëve dhe të dyshuarve që ende nuk kanë dëshmuar, me pasoja të pashmangshme për besueshmërinë dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre.<sup>25</sup>

---

*Leje për Apelimin e Vendimit F00470, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.*

<sup>23</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 5-6, që i referohen, ndër të tjera, para. 184 të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>24</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 16-18. Shih gjithashtu para. 20 të Kërkesës së Krasniqit.

<sup>25</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 21.

18. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Parë e Krasniqit nuk meriton leje për apel pasi nuk është formuluar në një mënyrë që i mundëson Trupit Gjykses të vlerësojë nëse i përmbush kriteret për miratimin e lejes për apel.<sup>26</sup>

19. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi, ndër të tjera, se provat e z. Krasniqi për TPNJ-në, të marra në mungesë të informimit shprehimisht të tij për të drejtën për mosinkriminimin e vetes, u dhanë vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm, domethënë u morën në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>27</sup> Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se provat që z. Krasniqi dha për TPNJ-në kishin vlerë provuese e cila nuk zhbëhej prej efektit dëmtues të tyre dhe, pasi konstatoi se dëshmitë ishin gjithashtu relevante dhe autentike, i pranoi ato si prova.<sup>28</sup> Sipas Trupit Gjykses, për pranimin si provë të një deklaratë dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një individ i cili në atë kohë dhe gjatë dhënies së intervistës apo dëshmisë nuk konsiderohej si i dyshuar, tërësia e paralajmërimeve që i bëhen personit të dyshuar nuk ishte parakusht ligjor.<sup>29</sup> Trupi Gjykses është i mendimit se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së,<sup>30</sup> aspekti nëse pranimi si prova në gjykimin aktual i dëshmise të dhëna nga z. Krasniqi në TPNJ në mungesë të informimit shprehimisht të tij për të drejtën për mosinkriminimin e vetes ishte shkelje e së drejtës së z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes, është një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Pika e Parë e Krasniqit buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

20. Sa i takon ndikimit të konsiderueshëm mbi kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjyimit, Trupi Gjykses vëren se pranimi i provave të z. Krasniqi për TPNJ-në shkel të drejtën e z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes mund të ndikojë në të drejtën e z. Krasniqi për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses

---

<sup>26</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 12.

<sup>27</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 194, 200, 204.

<sup>28</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 193, 196, 198-199, 200, 202-204, 206-207, 221(b).

<sup>29</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 194, 200, 204. *Shih gjithashtu* Vendimin e Kundërshtuar, para. 129, 159-160.

<sup>30</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 12.

është bindur se Mbrojtja e Krasniqit ka demonstruar se Pika e Parë e Krasniqit do të ndikonte në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.

21. Sa i përket aspektit nëse një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit për këtë pikë mund t'i kontribuojë thelbësisht procesit, Trupi Gjykses konsideron se për kryerjen e drejtë të procesit dhe për të drejtat e të akuzuarve është e rëndësishme që të ketë qartësi në lidhje me aspektin nëse pranimi i provave të z. Krasniqi për TPNJ-në në procesin aktual shkel të drejtën e z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre provave, një vendim për këtë aspekt do t'u mundësojë gjithashtu Mbrojtjes dhe Prokurorisë që të përgatisin paraqitjen e provave dhe parashtrimet përfundimtare të tyre bazuar në prova që i janë paraqitur Trupit Gjykses në mënyrë të vlefshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Parë të Krasniqit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit.

22. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses miraton lejen për apel në lidhje me Pikën e Parë të Krasniqit.

## **2. Pika e Dytë e Krasniqit**

23. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se standardi i zbatuar nga Trupi Gjykses për të përcaktuar nëse z. Krasniqi nuk kishte të drejtën e statusit dhe garancive të një të dyshuari kur dha dëshmi si dëshmitar, është i gabuar dhe devijon ndjeshëm nga standardet e zbatueshme të përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("GJEDNJ").<sup>31</sup> Mbrojtja e Krasniqit pretendon se Pika e Dytë e Krasniqit ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes, të drejtës për të heshtur, të drejtës për përfaqësim juridik dhe për t'u informuar për këto të drejta, që janë komponentë themelore të gjyqimit të drejtë dhe, për rrjedhojë,

---

<sup>31</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 7-8, që i referohen, ndër të tjera, para. 129 të Vendimit të Kundërshtuar.

ndikojnë në drejtësinë e përgjithshme të procesit dhe në rezultatin e gjykimit.<sup>32</sup> Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu argumenton se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Dytë të Krasniqit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit në mënyrën e përshkruar në paragrafin 17.<sup>33</sup>

24. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Dytë e Krasniqit nuk meriton leje për apel, pasi ajo nuk është shpjeguar mjaftueshëm që leja të miratohet.<sup>34</sup>

25. Trupi Gjykses rikujton se, në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi se provat e z. Krasniqi për TPNJ-në në cilësinë e dëshmitarit u dhanë vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe, rrjedhimisht, u morën në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>35</sup> Trupi Gjykses e bazoi këtë konstatim në premisën se, për pranimin si provë të një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një individ i cili në atë kohë dhe gjatë dhënies së intervistës apo dëshmisë nuk konsiderohej si i dyshuar, tërësia e paralajmërimeve që i bëhen personit të dyshuar nuk ishte parakusht ligjor.<sup>36</sup> Po ashtu, në lidhje me deklaratat e tjera përveç atyre që z. Krasniqi dha për TPNJ-në, Trupi Gjykses theksoi se nuk kishte asnjë tregues se autoritetet prokuroriale që morën provat prej të akuzuarit kishin vepruar në mënyrë të palejueshme.<sup>37</sup> Ky vlerësim nuk ishte përcaktues për konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me dhënien vullnetarisht të provave prej të akuzuarit dhe përputhshmërinë me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ai thjesht nënkuptonte se Trupi Gjykses u bind se nuk kishte asnjë tregues që TPNJ-ja i kishte marrë deklaratat ose kishte dëgjuar dëshminë e z. Krasniqi në një mënyrë që ishte në mospërputhje me kornizën ligjore për proceset para atij juridiksioni. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se, në kundërshtim me

---

<sup>32</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 16-18. *Shih gjithashtu* para. 20 të Kërkesës së Krasniqit.

<sup>33</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 21.

<sup>34</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 13.

<sup>35</sup> *Shih më lart* para. 19.

<sup>36</sup> *Shih më lart* para. 19.

<sup>37</sup> *Shih p.sh.* para. 191 të Vendimit të Kundërshtuar.

parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,<sup>38</sup> Pika e Dytë e Krasniqit keqinterpreteton konstatimet e Trupit Gjykues. Për rrjedhojë, Trupi Gjykues konstaton se Mbrojtja e Krasniqit nuk ka vërtetuar se Pika e Dytë e Krasniqit përbën temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

26. Duke pasur parasysh sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit për miratimin e lejes për apel në bazë të nenit 45(2) dhe rregullës 77(2). Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Dytë të Krasniqit rrëzohet.

### 3. Pika e Tretë e Krasniqit

27. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se, duke zbatuar standardin e gabuar për të përcaktuar se z. Krasniqi nuk kishte të drejtën e statusit dhe garancive të personit të dyshuar kur dha provat për TPNJ-në në cilësinë e dëshmitarit, Trupi Gjykues arriti në përfundimin e gabuar se z. Krasniqi nuk kishte të drejtën e informimit për privilegjin e mosinkriminimit të vetes, të qasjes në këshillim juridik dhe ushtrimin të së drejtës për të heshtur.<sup>39</sup> Mbrojtja e Krasniqit pretendon se Pika e Tretë e Krasniqit ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes, të drejtës për të heshtur, të drejtës për përfaqësim juridik si dhe për t'u informuar mbi këto të drejta, që janë komponentë themelore të gjykimit të drejtë dhe, për rrjedhojë, ndikojnë në drejtësinë e përgjithshme të procesit dhe në rezultatin e gjykimit.<sup>40</sup> Mbrojtja e Krasniqit argumenton më tej se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Tretë të Krasniqit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit në mënyrën e përshkruar në paragrafin 17.<sup>41</sup>

---

<sup>38</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 8.

<sup>39</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 7-8, që i referohen, ndër të tjera, para. 129 të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>40</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 16-18. Shih gjithashtu para. 20 të Kërkesës së Krasniqit.

<sup>41</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 21.

28. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Tretë e Krasniqit nuk meriton leje për apel, pasi nuk është shpjeguar mjaftueshëm që leja të miratohet.<sup>42</sup>

29. Trupi Gjykses rikujton se, në Vendimin e Kundërshtuar ai konstatoi se, për pranimin si provë të një deklaratë dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një individ i cili në atë kohë dhe gjatë dhënies së intervistës apo dëshmisë nuk konsiderohej si i dyshuar, tërësia e paralajmërimeve që i bëhen personit të dyshuar nuk ishte parakusht ligjor.<sup>43</sup> Trupi Gjykses gjithashtu arriti në përfundimin se provat e z. Krasniqi për TPNJ-në në cilësinë e dëshmitarit ishin dhënë vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe, rrjedhimisht, ishin marrë në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>44</sup> Trupi Gjykses është i mendimit se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së,<sup>45</sup> aspekti nëse z. Krasniqi kishte të drejtën e garancive të personit të dyshuar në kohën kur dha dëshmi në TPNJ përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Pika e Tretë e Krasniqit buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

30. Sa i takon ndikimit të konsiderueshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit, Trupi Gjykses thekson se aspekti nëse z. Krasniqi kishte të drejtën e garancive të personit të dyshuar në kohën që dha dëshmi në TPNJ, mund të ketë ndikim në pranueshmërinë e provave që ai i dha TPNJ-së dhe, për rrjedhojë, të drejtën e tij për gjykim të drejtë. Për këtë arsye, Trupi Gjykses është bindur se Mbrojtja e Krasniqit ka demonstruar se Pika e Tretë e Krasniqit do të kishte ndikim në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.

31. Sa i përket aspektit nëse një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit për këtë pikë mund t'i kontribuojë thelbësisht procesit, Trupi Gjykses vlerëson se për kryerjen e procesit dhe për të drejtat e të akuzuarve është e dobishme të ketë qartësi në lidhje me aspektin nëse z. Krasniqi kishte të drejtën e garancive të personit

---

<sup>42</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 13.

<sup>43</sup> *Shih më lart* para. 19.

<sup>44</sup> *Shih më lart* para. 19.

<sup>45</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 13.

të dyshuar në kohën e dhënies së provave për TPNJ-në. Gjithashtu, sikurse u theksua tashmë në lidhje me Pikën e Parë të z. Krasniqi, një vendim për këtë aspekt do t'u mundësojë gjithashtu Mbrojtjes dhe Prokurorisë që të përgatisin paraqitjen e provave dhe parashtrimet përfundimtare të tyre bazuar në prova që i janë paraqitur Trupit Gjykses në mënyrë të vlefshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Tretë të Krasniqit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit.

32. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses miraton lejen për apel në lidhje me Pikën e Tretë të Krasniqit.

#### **4. Pika e Katërt dhe Pika e Pestë e Krasniqit**

33. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se, duke konstatuar se nuk ka dallim thelbësor midis garancive mbrojtëse që iu dhanë z. Krasniqi sipas kornizës ligjore të TPNJ-së dhe atyre sipas sistemit të DHS-së, Trupi Gjykses: (i) nuk mori parasysh dallimin thelbësor se në vitin 2007 në TPNJ, zoti Krasniqi nuk u paralajmërua në lidhje me mosinkriminimin, gjë që kërkohet sipas Rregullores së DHS-së; dhe (ii) si rezultat, nuk pranoi të vlerësonte nëse ky nivel më i ulët i garancive mbrojtëse nuk përmbushte standardin e garancive minimale që kërkohen sipas kornizës ligjore të DHS-së.<sup>46</sup> Mbrojtja e Krasniqit pretendon se Pika e Katërt dhe Pika e Pestë e Krasniqit kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës së z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes, që është komponent themelor i gjyqimit të drejtë dhe, për rrjedhojë, ndikon në drejtësinë e përgjithshme të procesit dhe në rezultatin e gjyqimit.<sup>47</sup> Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu argumenton se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Katërt dhe Pikën e Pestë të Krasniqit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit në mënyrën e përshkruar në paragrafin 17.<sup>48</sup>

---

<sup>46</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 9-10, që i referohen para. 194, 200 të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>47</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 16-18. *Shih gjithashtu* para. 20 të Kërkesës së Krasniqit.

<sup>48</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 21.

34. ZPS-ja përgjigjet se: (i) Pika e Katërt e Krasniqit keqinterpretton Vendimin e Kundërshtuar; dhe (ii) Pika e Pestë e Krasniqit merr si premisë Pikën e Katërt të tij, që keqinterpretton Vendimin e Kundërshtuar dhe, rrjedhimisht, nuk meriton leje për apel.<sup>49</sup>

35. Mbrojtja e Krasniqit kundërpërgjigjet se gabimi i Trupit Gjykues qëndron në mosmarrjen parasysh të dallimit thelbësor midis garancive mbrojtëse që ofron TPNJ-ja dhe atyre të Rregullores së DHS-së dhe të pasojave të këtij gabimi juridik për të drejtën e z. Krasniqi për gjykim të drejtë.<sup>50</sup>

36. Trupi Gjykues rikujton se, në Vendimin e Kundërshtuar ai konstatoi se për pranimin si provë të një deklaratë dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një individ i cili në atë kohë dhe gjatë dhënies së intervistës apo dëshmisë nuk konsiderohej si i dyshuar, tërësia e paralajmërimeve që i bëhen personit të dyshuar nuk ishte parakusht ligjor.<sup>51</sup> Trupi Gjykues gjithashtu arriti në përfundimin se Zyra e Prokurorit të TPNJ-së nuk kishte detyrimin ligjor ta informonte z. Krasniqi për të drejtën e mosinkriminimit të vetes, pasi ai nuk konsiderohej si i dyshuar por si dëshmitar, dhe se nuk kishte asnjë dallim *thelbësor* midis garancive mbrojtëse sipas sistemit të TPNJ-së dhe atyre sipas kornizës ligjore të DHS-së.<sup>52</sup> Trupi Gjykues konstatoi gjithashtu se provat e z. Krasniqi për TPNJ-në në cilësinë e dëshmitarit u dhanë vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe, rrjedhimisht, u morën në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>53</sup> Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,<sup>54</sup> respektimi nga TPNJ-ja i standardeve dhe procedurave të saj nuk ishte përcaktues për vendimin e Trupit Gjykues për pranimin e atyre provave. Ashtu si kur është fjala për respektimin e legjislacionit vendor nga autoritetet shtetërore, edhe

---

<sup>49</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 14-16.

<sup>50</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 5.

<sup>51</sup> *Shih më lart* para. 19.

<sup>52</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 194, 200, 204.

<sup>53</sup> *Shih më lart* para. 19.

<sup>54</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 9-10.

aspekti nëse TPNJ-ja i respektoi standardet e veta është thjesht një konsideratë faktike që mund të ketë ndikim në vendimin e Trupit Gjykses për pranimin e provave.<sup>55</sup> Në rastin aktual nuk ka tregues se TPNJ-ja nuk i respektoi standardet e veta. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Katërt dhe Pika e Pestë e Krasniqit keqinterpretojnë konstatimet e lartpërmendura të Trupit Gjykses dhe përbëjnë thjesht mospajtim me to. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Krasniqit nuk ka vërtetuar se Pika e Katërt dhe Pika e Pestë e Krasniqit përbëjnë tema më vete që burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar.

37. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2). Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Katërt dhe Pikën e Pestë të Krasniqit rrëzohet.

## 5. Pika e Gjashtë dhe Pika e Shtatë e Krasniqit

38. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se Trupi Gjykses nuk mori parasysh faktin se mosparalajmërimi në lidhje me vetinkriminimin, shoqëruar me detyrimin për të treguar të vërtetën, betimin përkatës dhe trysninë shtesë të urdhërparaqitjes për të dëshmuar si dëshmitar, i ngarkuan z. Krasniqi një barrë të tepruar, duke ia bërë të pamundur ushtrimin e njëmendtë të së drejtës për mosinkriminimin e vetes.<sup>56</sup> Mbrojtja e Krasniqit parashtron se Pika e Gjashtë dhe Pika e Shtatë e Krasniqit kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës për mosinkriminimin e vetes, që është komponent themelor i gjykimit të drejtë dhe, për rrjedhojë, ndikon në drejtësinë e përgjithshme të procesit dhe në rezultatin e gjykimit.<sup>57</sup> Mbrojtja e Krasniqit argumenton gjithashtu se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Gjashtë

---

<sup>55</sup> *Shih p.sh.* TPNJ, *Prokurori kundër Haraqisë dhe Morinës*, IT-04-84-R77.4-A, Dhoma e Apelit, [Judgement](#) (Aktgjykim), 23 korrik 2009, para. 28; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Accused's Motion to Exclude Intercepted Conversations, 30 September 2010](#), para. 7, 10, 11.

<sup>56</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 11-12, që u referohen para. 200 dhe 204 të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>57</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 16-18. *Shih gjithashtu* para. 20 të Kërkesës së Krasniqit.

dhe Pikën e Shtatë të Krasniqit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit në mënyrën e përshkruar në paragrafin 17.<sup>58</sup>

39. ZPS-ja përgjigjet se: (i) Pika e Gjashtë dhe Pika e Shtatë e Krasniqit janë tejet abstrakte për t'u cilësuar si të apelueshme; dhe (ii) pretendimi në Pikën e Shtatë të Krasniqit, se aspektet që trajtoi shprehimisht Trupi Gjykses nuk u shqyrtuan në kombinim me njëra-tjetrën, keqinterpreton Vendimin e Kundërshtuar.<sup>59</sup>

40. Mbrojtja e Krasniqit kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk kupton se si Pika e Gjashtë dhe Pika e Shtatë e Krasniqit kanë të bëjnë me atë se Vendimi i Kundërshtuar faktikisht i hoqi të akuzuarit një të drejtë themelore të gjyqimit të drejtë.<sup>60</sup> Sipas Mbrojtjes së Krasniqit, parashtrimet e ZPS-së nuk janë asgjë më shumë se pretendime të pabazuara.<sup>61</sup>

41. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi se udhërparaqitja është thjesht instrument procedural që përdoret për ta sjellë dëshmitarin në gjykatë për të dhënë dëshmi dhe se nuk kishte asnjë tregues se urdhërparaqitja për z. Krasniqi kishte rezultuar në dhënien prej tij të informacionit inkriminues, të cilin ai ndryshe nuk do të kishte qenë i gatshëm t'ia jepte TPNJ-së gjatë dëshmisë së tij në gjykim, në maj 2007.<sup>62</sup> Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se: (i) mosinformimi shprehimisht i dëshmitarit për të drejtën e tij për mosinkriminimin e vetes kur nuk ka arsye për ta bërë këtë informim, si dhe mosinformimi shprehimisht i dëshmitarit për mundësinë e përfaqësimit juridik, nuk ndikojnë në aspektin e dhënies vullnetarisht të dëshmisë ose në mbështetshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit; dhe (ii) betimi nën të cilin z. Krasniqi dëshmoi si dëshmitar në TPNJ nuk e detyroi atë të hiqte dorë nga e drejta e mosinkriminimit të vetes, por e bëri ushtrimin e saj objekt të një procedure të

---

<sup>58</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 21.

<sup>59</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 17-18. *Shih gjithashtu* para. 20 të Përgjigjes së ZPS-së.

<sup>60</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 7.

<sup>61</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 7.

<sup>62</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 200.

veçantë të përcaktuar në Rregulloren e TPNJ-së.<sup>63</sup> Gjithashtu Trupi Gjykues vlerësoi, ndër të tjera, se provat e z. Krasniqi për TPNJ-në në cilësinë e dëshmitarit u dhanë vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe, rrjedhimisht, u morën në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>64</sup> Pika e Gjashtë dhe Pika e Shtatë e Krasniqit shprehin thjesht mospajtim me konstatimet e Trupit Gjykues dhe nuk vënë në dukje ndonjë gabim sipas kuptimit të rregullës 77(2). Trupi Gjykues i mori parasysh sa duhet mungesën e informimit shprehimisht të tij për të drejtën e mosinkriminimit të vetes, faktin se z. Krasniqi mori urdhërparaqitje për të dëshmuar, si dhe nëse këta faktorë patën ndikim sa i takon dhënies së dëshmisë për TPNJ-në vullnetarisht.<sup>65</sup> Trupi Gjykues arriti në përfundimin se, për arsyet e paraqitura më lart, këta faktorë nuk patën ndikim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues është i mendimit se Pika e Gjashtë dhe Pika e Shtatë e Krasniqit përbëjnë thjesht mospajtim me konstatimet e Trupit Gjykues lidhur me dhënien vullnetarisht të provave nga z. Krasniqi për TPNJ-në. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se Mbrojtja e Krasniqit nuk ka vërtetuar se Pika e Gjashtë dhe Pika e Shtatë e Krasniqit përbëjnë tema më vete që burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar.

42. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2). Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Gjashtë dhe Pikën e Shtatë të Krasniqit rrëzohet.

## 6. Pika e Tetë e Krasniqit

43. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se Trupi Gjykues bëri gabim juridik dhe/ose faktik që konstatoi se garantitë mbrojtëse të parashikuara në rregullën 90(E) të

---

<sup>63</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 204.

<sup>64</sup> *Shih më lart* para. 19.

<sup>65</sup> *Shih* para. 11 të Kërkesës së Krasniqit.

Rregullores së TPNJ-së nuk përfshinin proceset e DHS-së, duke e bërë rrjedhimisht të paefektshme të drejtën themelore të mbrojtur nga neni 6 i Konventës.<sup>66</sup> Mbrojtja e Krasniqit pretendon se Pika e Tetë e Krasniqit ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes, që është komponent themelor i gjykimit të drejtë dhe, për rrjedhojë, ndikon në drejtësinë e përgjithshme të procesit dhe në rezultatin e gjykimit.<sup>67</sup> Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu argumenton se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Tetë të Krasniqit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit në mënyrën e përshkruar në paragrafin 17.<sup>68</sup>

44. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Tetë e Krasniqit nuk meriton leje për apel, pasi: (i) shtjellimi i argumentit të Mbrojtjes së Krasniqit nuk përputhet me pikën në mënyrën si është përmbledhur; dhe (ii) Mbrojtja e Krasniqit keqinterpreteton Vendimin e Kundërshtuar kur pretendon se pikat e trajtuara shprehimisht nga Trupi Gjykses nuk janë shqyrtuar të kombinuara me njëra-tjetrën.<sup>69</sup>

45. Mbrojtja e Krasniqit kundërpërgjigjet se si rezultat i interpretimit të ngushtë të rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së prej Trupit Gjykses, dëshmitarëve iu është hequr *de facto* çdo garanci mbrojtëse kundër vetinkriminimit.<sup>70</sup>

46. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses: (i) konstatoi se në rastin e një personi që merret në pyetje si dëshmitar nuk është e zbatueshme tërësia e paralajmërimeve që duhet të jepen në rastin e një të dyshuari;<sup>71</sup> dhe (ii) iu referua jurisprudencës së TPNJ-së, duke theksuar se garancitë mbrojtëse kundër vetinkriminimit të parashikuara në rregullën 90(E) të Rregullores së TPNJ-së zbatoheshin vetëm në TPNJ dhe nuk ishin krijuar për t'u zbatuar jashtë

---

<sup>66</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 2(viii). *Shih gjithashtu* para. 13-14 të Kërkesës së Krasniqit, që i referohen para. 159 të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>67</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 16-18. *Shih gjithashtu* para. 20 të Kërkesës së Krasniqit.

<sup>68</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 21.

<sup>69</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 19-20.

<sup>70</sup> Kundërpërgjigja e Krasniqit, para. 6. *Shih gjithashtu* para. 7 të Kundërpërgjigjes së Krasniqit.

<sup>71</sup> *Shih më lart* para. 19.

juridiksionit të TPNJ-së.<sup>72</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi, ndër të tjera, se provat e z. Krasniqi për TPNJ-në, në cilësinë e dëshmitarit, u dhanë vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe, rrjedhimisht, u morën në një mënyrë që është në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>73</sup> Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,<sup>74</sup> Trupi Gjykses faktikisht nuk e la pa shqyrtuar mënyrën se si ndikonte mospërcaktimi në Rregulloren e TPNJ-së i detyrimit për të paralajmëruar shprehimisht dhe paraprakisht dëshmitarët për të drejtën e mosinkriminimit të vetes, në garancitë mbrojtëse të z. Krasniqi kundër vetinkriminimit. Gjithashtu, sikurse u përmend edhe më lart, vlerësimi prej Trupit Gjykses i respektimit nga TPNJ-ja i kornizës ligjore të saj, nuk ishte përcaktues për pranueshmërinë e provave, por vetëm një prej një sere faktorësh relevantë për atë vendim.<sup>75</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerëson se Pika e Tetë e Krasniqit përbën thjesht mospajtim me konstatimet e lartpërmendura të Trupit Gjykses. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Krasniqit nuk ka vërtetuar se Pika e Tetë e Krasniqit përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

47. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2). Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Tetë të Krasniqit rrëzohet.

---

<sup>72</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 159, që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-AR73.11, Appeals Chamber, [Decision on Appeal against the Decision on the Accused's Motion to Subpoena Zdravko Tolimir](#), 13 November 2013, para. 43; *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-T, [Decision on Prosecution Motion for an Advance Ruling on the Scope of Permissible Cross Examination](#), 12 June 2009, para. 21.

<sup>73</sup> *Shih më lart* para. 19.

<sup>74</sup> *Shih* para. 13-14 të Kërkesës së Krasniqit.

<sup>75</sup> *Shih më lart* para. 36 (dhe referencat e cituara aty).

## 7. Pika e Nëntë e Krasniqit

48. Mbrojtja e Krasniqit kërkon leje për apelimin e vendimit të Trupit Gjykses për pranimin si prova të deklaratave të mëhershme të z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi, që mund të kenë lidhje me z. Krasniqi.<sup>76</sup> Mbrojtja e Krasniqit pretendon se Pika e Nëntë e Krasniqit ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes dhe shkeljen e së drejtës për proces ballafaques dhe për të marrë në pyetje, ose që të merren në pyetje në emër të tij, dëshmitarët kundër tij – që janë komponentë themelorë të gjykimit të drejtë dhe, rrjedhimisht, ndikojnë në drejtësinë e përgjithshme të procesit dhe në rezultatin e gjykimit.<sup>77</sup> Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu argumenton se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Nëntë të Krasniqit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit në mënyrën e përshkruar në paragrafin 17 si dhe do të qartësonte: (i) kompetencën e Trupit Gjykses për të pranuar prova të paverifikuara, të cilat nuk janë të përfshira në rastet specifike të përcaktuara në Rregullore; dhe (ii) saktësinë e balancimit të bërë midis vlerës provuese të provës dhe dëmit të shkaktuar nga pranimi i saj.<sup>78</sup>

49. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Nëntë e Krasniqit nuk meriton leje për apel pasi formulimi i saj është tejet abstrakt.<sup>79</sup>

50. Mbrojtja e Krasniqit kundërpërgjigjet se në Përgjigjen e saj, ZPS-ja nuk merr parasysh: (i) sasinë e provave të paverifikuara të pranuar në dokumentacionin e çështjes dhe ndikimin e tyre mbi të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë; dhe (ii) gabimin në konstatimin e Trupit Gjykses se dëmi i shkaktuar nga pamundësia e z. Krasniqi për t'u bërë pyetje të akuzuarve të tjerë nuk zhbën vlerën provuese të deklaratave të tyre.<sup>80</sup>

---

<sup>76</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 15, që i referohet para. 216-217 të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>77</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 16-19. *Shih gjithashtu* para. 20 të Kërkesës së Krasniqit.

<sup>78</sup> Kërkesa e Krasniqit, para. 21-22.

<sup>79</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 21-22.

<sup>80</sup> Kundërpërgjigja e Krasniqit, para. 8.

51. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi se korniza ligjore e zbatueshme nuk ndalon pranimin e deklaratës së një të akuzuari kundër të bashkëpandehurve dhe se pranimi i deklaratës së një të akuzuari nuk dëmton, në vetvete, të akuzuarin apo të bashkakuzuarin.<sup>81</sup> Trupi Gjykses është i mendimit se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së,<sup>82</sup> aspekti nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik kur nxori këto konstatime dhe pranoi deklaratat e të akuzuarit kundër katër të akuzuarve, përbën temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Pika e Nëntë e Krasniqit buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

52. Sa i takon ndikimit të konsiderueshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit, Trupi Gjykses thekson se aspekti nëse Trupi Gjykses gaboi që pranoi deklaratat e të akuzuarit kundër katër të akuzuarve, mund të ndikojë në të drejtën e z. Krasniqi për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se Mbrojtja e Krasniqit ka demonstruar se Pika e Nëntë e Krasniqit do të ndikonte në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.

53. Sa i përket aspektit nëse një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit për këtë pikë mund t'i kontribuojë thelbësisht procesit, Trupi Gjykses vlerëson se për kryerjen e procesit dhe për të drejtat e të akuzuarve është e dobishme të ketë qartësi në lidhje me aspektin nëse Trupi Gjykses gaboi që pranoi deklaratat e të akuzuarit kundër katër të akuzuarve. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre deklaratave, një vendim për këtë aspekt do t'u mundësojë gjithashtu Mbrojtjes dhe Prokurorisë që të përgatisin paraqitjen e provave dhe parashtrimet përfundimtare të tyre bazuar në prova që i janë paraqitur Trupit Gjykses në mënyrë të vlefshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Nëntë të Krasniqit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit.

---

<sup>81</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 217, 219.

<sup>82</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 22.

54. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses miraton lejen për apel në lidhje me Pikën e Nëntë të Krasniqit.

## B. PIKAT E VESELIT

### 1. Pika e Parë e Veselit

55. Mbrojtja e Veselit parashtron se Trupi Gjykses u bazua në tri dispozita në lidhje me pranimin e deklaratave të një të pandehuri, por nuk mori parasysh dispozitën kryesore në lidhje me përdorimin e atyre deklaratave kundër një të bashkakuzuari – konkretisht, nenin 123 të KPPK-së.<sup>83</sup> Mbrojtja e Veselit pretendon se Pika e Parë e Veselit ka të bëjë me një gabim juridik themelor që do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në drejtësinë e procesit dhe në rezultatin e këtij gjykimi.<sup>84</sup> Mbrojtja e Veselit gjithashtu argumenton se një vendim pozitiv nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me Pikën e Parë të Veselit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit dhe do të mbrojë të drejtën e Veselit për ballafaqim me personat që kanë dhënë deklarata kundër tij.<sup>85</sup>

56. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Parë e Veselit nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar pasi: (i) pretendimi i Mbrojtjes së Veselit se Trupi Gjykses nuk e mori aspak parasysh nenin 123 të KPPK-së, është i pavërtetë; dhe (ii) neni 123 i KPPK-së nuk është përfshirë shprehimisht në Rregullore.<sup>86</sup>

57. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se Pika e Parë e Veselit buron nga Vendimi i Kundërshtuar, pavarësisht se i është referuar një versioni të shfuqizuar të KPPK-së.<sup>87</sup>

58. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi se as Kushtetuta e Kosovës dhe as Ligji dhe Rregullorja, nuk trajtojnë specifikisht aspektin e pranueshmërisë së deklaratave të të bashkëpandehurve.<sup>88</sup> Trupi Gjykses

<sup>83</sup> Kërkesa e Veselit, para. 12, që i referohet para. 215 të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>84</sup> Kërkesa e Veselit, para. 16-18, që i referohen para. 216 të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>85</sup> Kërkesa e Veselit, para. 20.

<sup>86</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 2-3.

<sup>87</sup> Kundërpërgjigja e Veselit, para. 2.

<sup>88</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 215.

gjithashtu gjykoi se dispozitat e KPPK-së që trajtojnë pranimin e deklaratave të dhëna nga i pandehuri, në veçanti nenet 119(5), 256(1) dhe 257(2) të KPPK-së, nuk janë pjesë e sistemit normativ të DHS-së dhe nuk zbatohen në këtë proces.<sup>89</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses arriti në përfundimin se pranimi i deklaratave të bashkëpandehurve bëhet në bazë të rregullave dhe parimeve të përgjithshme për pranimin e provave në DHS, para së gjithash, rregullës 138(1). Trupi Gjykses konstatoi se, siç parashikohet në rregullën 140(4) dhe pasqyrohet në nenet 119(5), 256(1) dhe 257(2) të KPPK-së, fajësia e të akuzuarit nuk mund të bazohet vetëm, ose në një masë vendimtare në deklaratatë të tilla.<sup>90</sup> Siç ka vënë saktë në dukje ZPS-ja dhe është pranuar nga Mbrojtja e Veselit,<sup>91</sup> Trupi Gjykses beson se dispozita së cilës i referohet Mbrojtja e Veselit në parashtrimet e saj është neni 123 i versionit të KPPK-së të vitit 2012, që është neni 119 në versionin e KPPK-së në fuqi aktualisht, i cili u mor parasysh prej Trupit Gjykses gjatë vlerësimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Rrjedhimisht, është e qartë se, në kundërshtim me çka parashtron Mbrojtja e Veselit,<sup>92</sup> Trupi Gjykses nuk ka shpërfillur asnjë dispozitë të KPPK-së lidhur me deklaratat e të akuzuarve. Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Parë e Veselit keqinterpretonte konstatimet e Trupit Gjykses mbi dispozitat ligjore të zbatueshme për pranimin e deklaratave të akuzuarve kundër të bashkakuzuarve, dhe përbën thjesht mospajtim me to. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Veselit nuk ka vërtetuar se Pika e Parë e Veselit përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

59. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2). Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Parë të Veselit rrëzohet.

---

<sup>89</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 215.

<sup>90</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 215. *Shih gjithashtu* para. 16 dhe 218 të Vendimit të Kundërshtuar

<sup>91</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 2-3; Kundërpërgjigja e Veselit, para. 2.

<sup>92</sup> Kërkesa e Veselit, para. 12.

## 2. Pika e Dytë e Veselit

60. Mbrojtja e Veselit parashtroi se duke lejuar përdorimin e deklaratave të të akuzuarve kundër të bashkakuazuarve, Trupi Gjykes bëri gabim juridik që nuk zbatoi interpretimin më të favorshëm për të akuzuarit, siç kërkohet sipas rregullave 4(3) dhe 5.<sup>93</sup> Mbrojtja e Veselit pretendon se Pika e Dytë e Veselit ka të bëjë me një gabim juridik themelor që ndikon drejtpërdrejt në drejtësinë e procesit dhe rezultatin e këtij gjykimi.<sup>94</sup> Mbrojtja e Veselit argumenton gjithashtu se një vendim pozitiv për Pikën e Dytë të Veselit nga Paneli i Gjykatës së Apelit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit dhe do të mbrojtë të drejtën e Veselit për t'u ballafaquar me ata që kanë dhënë deklarata kundër tij.<sup>95</sup>

61. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Dytë e Veselit nuk meriton të shqyrtohet në apel, pasi nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar dhe e keqinterpreton atë.<sup>96</sup> ZPS-ja parashtroi se: (i) Mbrojtja e Veselit nuk demonstroi se burimet ligjore të parapëlqyera prej saj identifikojnë një parim të përgjithshëm juridik dhe se ato do të çonin në një rezultat të ndryshëm; dhe se (ii) Mbrojtja e Veselit përzgjedh vetëm pjesën e analizës së Vendimit të Kundërshtuar që është e volitshme për të në lidhje me këtë pikë.<sup>97</sup>

62. Në Kundërpërgjigje, Mbrojtja e Veselit rithekson se Trupi Gjykes nuk mori parasysh rregullën 4(3) dhe 5 të Rregullores dhe, rrjedhimisht, dha një Vendim të bazuar në një interpretim të Rregullores që ishte më i pafavorshmi për të akuzuarin.<sup>98</sup>

63. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykes konstatoi se: (i) as Kushtetuta e Kosovës dhe as Ligji dhe Rregullorja, nuk trajtojnë specifikisht aspektin e pranueshmërisë së deklaratave të të bashkëpandehurve;<sup>99</sup> dhe (ii) pranimi i

---

<sup>93</sup> Kërkesa e Veselit, para. 13-15.

<sup>94</sup> Kërkesa e Veselit, para. 16, 19.

<sup>95</sup> Kërkesa e Veselit, para. 20.

<sup>96</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 4.

<sup>97</sup> Përgjigja e ZPS-së, para. 4-5.

<sup>98</sup> Kundërpërgjigja e Veselit, para. 4.

<sup>99</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 215.

deklaratave të bashkëpandehurve bëhet në bazë të rregullave dhe parimeve të përgjithshme për pranimin e provave në DHS.<sup>100</sup> Në arritjen e këtij përfundimi Trupi Gjykses vuri në dukje: (i) mungesën e një parimi të përgjithshëm juridik ose detyrimi lidhur me të drejtat e njeriut që do t'i bënte këto prova të papranueshme, apo që do ta bënte pranimin e tyre të padrejtë ndaj një të akuzuari në një proces penal;<sup>101</sup> dhe (ii) jurisprudencën e gjykatave të tjera penale ndërkombëtare (të ndërkombëtarizuara), sipas së cilës, pranimi i deklaratave të një të akuzuari kundër të bashkëpandehurit/bashkëpandehurve nuk cenon të drejtën e këtyre të fundit për gjykim të drejtë, me kusht që vlera provuese e deklaratave të mos zhbëhet nga efekti dëmtues që mund t'i shkaktojë pranimi i tyre të bashkëpandehurit/bashkëpandehurve.<sup>102</sup> Në kundërshtim me atë që parashton Mbrojtja e Veselit,<sup>103</sup> Trupi Gjykses nuk konstatoi se korniza ligjore të DHS-së nuk trajton pranimin e deklaratave të të akuzuarve, që të bëjë të nevojshëm zbatimin e rregullave 4(3) dhe 5. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk ishte i detyruar të vendoste se cili prej dy interpretimeve të Rregullores ishte më i favorshëm për të akuzuarin. Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Dytë e Veselit keqinterpretton konstatimet e tij mbi dispozitat ligjore të zbatueshme për pranimin e deklaratave të të akuzuarve kundër të bashkakuzuarve, dhe përbën thjesht mospajtim me përfundimet e arritura prej tij. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Veselit nuk ka vërtetuar se Pika e Dytë e Veselit përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

64. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2).

---

<sup>100</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 16, 215.

<sup>101</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 216.

<sup>102</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 216, që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.6, Appeals Chamber, [Decision on Appeals Against Decision Admitting Transcript of Jadranko Prlić's Questioning Into Evidence](#), 23 November 2007, para. 62; *Prosecutor v. Gotovina et al.*, IT-06-90-T, Trial Chamber I, [Judgement](#), 15 April 2011, para. 44; *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1, Trial Chamber, [Decision on the Admission of the Record of Interview of the Accused Kvočka](#), 16 March 2001.

<sup>103</sup> Kërkesa e Veselit, para. 14-15.

Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Dytë të Veselit rrëzohet.

## C. PIKAT E SELIMIT

### 1. Pika e Parë e Selimit

65. Mbrojtja e Selimit parashtron se mosinformimi i të dyshuarit për të drejtën për gjykim të drejtë përbën një mangësi veçanërisht të rëndësishme sa i takon kryerjes së intervistave me të dyshuarit; megjithatë, Trupi Gjykses nuk shpjegoi se pse u pranuan si prova pjesët përkatëse të intervistës së z. Selimi, kur, në shkelje të rregullës 43(4), ai nuk u informua si duhet për këto të drejta.<sup>104</sup> Mbrojtja e Selimit pretendon se Pika e Parë e Selimit ngre dyshimin se provat e pranuar nga Trupi Gjykses u morën në shkelje të të drejtave që i akordohen një të dyshuari në kontekstin e hetimeve penale, dhe, sipas saj, një vendim në lidhje me këtë pikë ka rëndësi jetike për të siguruar kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.<sup>105</sup> Mbrojtja e Selimit gjithashtu argumenton se një vendim për Pikën e Dytë të Selimit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit aktual, sepse u mundëson ZPS-së dhe Mbrojtjes që t'i paraqesin provat dhe argumentet përkatëse duke pasur njohuri të plota për provat që do t'u duhet të kundërshtojnë dhe për aspektet për të cilat do t'u duhet të paraqesin prova të mëtejshme.<sup>106</sup>

66. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Parë e Selimit keqinterpretonte Vendimin e Kundërshtuar pasi Trupi Gjykses: (i) faktikisht e shpjegoi pse e pranoi si provë transkriptin e intervistës së Selimit që i parapriu informimit se mund të riaktivizonte të drejtën për të pasur mbrojtës; dhe (ii) nuk konstatoi se kishte shkelje të rregullës 43(4).<sup>107</sup>

---

<sup>104</sup> Kërkesa e Selimit, para. 3-5, që i referohen, ndër të tjera, para. 45 të Vendimit të Kundërshtuar. *Shih gjithashtu* para. 21 të Kërkesës së Selimit.

<sup>105</sup> Kërkesa e Selimit, para. 22, 25.

<sup>106</sup> Kërkesa e Selimit, para. 26. *Shih gjithashtu* para. 27-28 të Kërkesës së Selimit.

<sup>107</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 6.

67. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses theksoi se para intervistës së nëntorit 2019 me ZPS-në, z. Selimi u informua se: (i) intervista po incizohej; (ii) kishte të drejtën për të heshtur; (iii) kishte të drejtën të ndihmohej nga një avokat; (iv) çdo deklaratë e bërë mund të përdorej si provë kundër tij në DHS; dhe (v) kishte të drejtën për të pasur përkthyes pa pagesë.<sup>108</sup> Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se: (i) zotit Selimi iu dha një dokument me shkrim për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe ai u informua se mund të riaktivizonte të drejtën për të pasur avokat dhe të kërkonte ndihmën e avokatit në çdo moment; dhe (ii) informimi me vonesë i z. Selimi për të drejtën e riaktivizimit të përfaqësimit me avokat nuk ndikoi në kuptimin prej tij të së drejtës për heqje dorë nga e drejta për të heshtur, sepse Rregulloja nuk përmban ndonjë kriter tekstual që personi duhet të informohet shprehimisht për mundësinë e heqjes dorë nga e drejta për të heshtur.<sup>109</sup> Trupi Gjykses arriti në përfundimin se z. Selimi ishte informuar në mënyrë të plotë për të drejtat e tij si i dyshuar dhe se ai hoqi dorë nga e drejta për të pasur avokat vullnetarisht dhe në mënyrë të qartë, të vetëdijshme dhe racionale.<sup>110</sup> Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Selimit,<sup>111</sup> Trupi Gjykses shpjegoi pse u pranuan si prova pjesët përkatëse të intervistës së nëntorit 2019 të z. Selimi me ZPS-në. Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Parë e Selimit përbën thjesht mospajtim me konstatimet e lartpërmendura të tij. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Selimit nuk ka vërtetuar se Pika e Parë e Selimit përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

68. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2).

---

<sup>108</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 45.

<sup>109</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 45.

<sup>110</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 47.

<sup>111</sup> Kërkesa e Selimit, para. 4.

Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Parë të Selimit rrëzohet.

## 2. Pika e Dytë e Selimit

69. Mbrojtja e Selimit kundërshton konstatimin e Trupit Gjykses se “z. Selimi kishte dijeni për statusin e tij si i dyshuar në kohën e intervistës së tij në nëntor 2019, si dhe për të drejtat që lidhen me atë status”, bazuar në faktin se gjatë asaj interviste për z. Selimi ishte përdorur vazhdimisht fjala “dëshmitar”.<sup>112</sup> Mbrojtja e Selimit pretendon se Pika e Dytë e Selimit ngre dyshimin se provat e pranuar nga Trupi Gjykses ishin marrë në shkelje të të drejtave që i akordohen një të dyshuari në kontekstin e hetimeve penale dhe, sipas saj, një vendim në lidhje me këtë pikë ka rëndësi jetike për të siguruar kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.<sup>113</sup> Mbrojtja e Selimit gjithashtu argumenton se një vendim mbi Pikën e Dytë të Selimit do t’i kontribuojë thelbësisht procesit aktual sepse u mundëson ZPS-së dhe Mbrojtjes që t’i paraqesin provat dhe argumentet përkatëse duke pasur njohuri të plota për provat që do t’u duhet të kundërshtojnë dhe për aspektet për të cilat do t’u duhet të paraqesin prova të mëtejshme.<sup>114</sup>

70. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Dytë të Selimit nuk meriton leje për apel, pasi përbën thjesht mospajtim me përfundimin e arritur nga Trupi Gjykses se z. Selimi kishte dijeni për statusin e tij si i dyshuar.<sup>115</sup>

71. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi se: (i) para intervistës së nëntorit 2019 me ZPS-në, z. Selimi u informua qartë se dyshohej se ishte përfshirë në kryerjen e një veprë penale; dhe (ii) rrjedhimisht, në kohën e intervistës së nëntorit 2019, z. Selimi kishte dijeni për statusin e tij si i dyshuar dhe

---

<sup>112</sup> Kërkesa e Selimit, para. 6-8, që i referohen, ndër të tjera, para. 43 të Vendimit të Kundërshtuar. *Shih gjithashtu* para. 21 të Kërkesës së Selimit.

<sup>113</sup> Kërkesa e Selimit, para. 22, 25.

<sup>114</sup> Kërkesa e Selimit, para. 26. *Shih gjithashtu* para. 27-28 të Kërkesës së Selimit.

<sup>115</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 7.

për të drejtat që lidheshin me atë status.<sup>116</sup> Trupi Gjykses gjithashtu vuri në dukje se z. Selimi ishte informuar në mënyrë të plotë për të drejtat e tij si i dyshuar<sup>117</sup> dhe konfirmoi se i kuptonte ato.<sup>118</sup> Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstatoi se nuk kishte tregues se z. Selimi kishte qenë ndonjëherë i paqartë për statusin e tij si i dyshuar.<sup>119</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Dytë e Selimit vetëm sa përsërit argumentet që i janë parashtruar edhe më parë Trupit Gjykses<sup>120</sup> dhe përbën thjesht mospajtim me konstatimet e lartpërmendura të Trupit Gjykses. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Selimit nuk ka vërtetuar se Pika e Dytë e Selimit përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

72. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2). Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Dytë të Selimit rrëzohet.

### 3. Pika e Tretë e Selimit

73. Mbrojtja e Selimit parashtron se arsyetimi i Trupit Gjykses në Vendimin e Kundërshtuar duket se barazon dhe ngatërron dy aspekte thelbësisht të ndryshme, konkretisht: (i) nëse pranimi provave ishte në përputhje me të drejtat që u akordohen dëshmitarëve; dhe (ii) nëse pranimi i provave ishte në përputhje me të drejtat që u akordohen të akuzuarve.<sup>121</sup> Mbrojtja e Selimit pretendon se Pika e Tretë e Selimit ndikon drejtpërdrejt në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe në rezultatin e

---

<sup>116</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 43.

<sup>117</sup> *Shih më lart* para. 67.

<sup>118</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 46.

<sup>119</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 46.

<sup>120</sup> *Shih p.sh.* F01473, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 24 prill 2023, para. 2, 14-15, 17-20, 22, 26, 30, 37.

<sup>121</sup> Kërkesa e Selimit, para. 9-11, *që u referohen* para. 129 dhe 141 të Vendimit të Kundërshtuar. *Shih gjithashtu* para. 21 të Kërkesës së Selimit.

gjkimit pasi ajo ngre dyshimin se: (i) provat e pranuar nga Trupi Gjykes u morën në shkelje të të drejtave të të dyshuarve në kontekstin e hetimeve penale; dhe (ii) vlera provuese e tyre zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.<sup>122</sup> Mbrojtja e Selimit gjithashtu argumenton se një vendim për Pikën e Tretë të Selimit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit aktual, sepse u mundëson ZPS-së dhe Mbrojtjes që t'i paraqesin provat dhe argumentet përkatëse duke pasur njohuri të plota për provat që do t'u duhet të kundërshtojnë dhe për aspektet për të cilat do t'u duhet të paraqesin prova të mëtejshme.<sup>123</sup>

74. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Tretë e Selimit nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar, pasi Trupi Gjykes analizoi me qartësi nëse pranimi si prova i deklaratave të z. Selimi ishte në përputhje me të drejtat e tij.<sup>124</sup>

75. Mbrojtja e Selimit kundërpërgjigjet se thjesht përsëritja prej ZPS-së e konstatimeve të Trupit Gjykes nuk përbën vërtetim të pretendimit të pambështetur të saj se pika e ngritur nga Mbrojtja e Selimit nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar.<sup>125</sup>

76. Trupi Gjykes rikujton se miratoi lejen për apel për Pikën e Parë dhe Pikën e Tretë të Krasniqit lidhur me: (i) nëse pranimi i provave të dhëna në mungesë të informimit shprehimisht të tij për të drejtën për mosinkriminimin e vetes, shkeli të drejtën e të akuzuarit për mosinkriminimin e vetes;<sup>126</sup> dhe (ii) nëse i akuzuari kishte të drejtën e garancive të një të dyshuari në kohën kur dha dëshmi në TPNJ.<sup>127</sup> Trupi Gjykes është i mendimit se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së,<sup>128</sup> të njëjtët faktorë ku u mbështet vendimi për miratimin e lejes për apel në lidhje me Pikën e Parë dhe Pikën e Tretë të Krasniqit vlejnë edhe për Pikën e Tretë të Selimit lidhur me aspektin nëse

---

<sup>122</sup> Kërkesa e Selimit, para. 22-23, 25.

<sup>123</sup> Kërkesa e Selimit, para. 26. *Shih gjithashtu* para. 27-28 të Kërkesës së Selimit.

<sup>124</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 8.

<sup>125</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 2. *Shih gjithashtu* para. 3 të Kundërpërgjigjes së Selimit.

<sup>126</sup> *Shih më lart* para. 19-22.

<sup>127</sup> *Shih më lart* para. 29-32.

<sup>128</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 8, 12-13.

Trupi Gjykses gaboi që pranoi deklaratat dhe dëshminë e dhëna nga z. Selimi si dëshmitar, në shkelje të të drejtave të tij të mëpasshme si i akuzuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se: (i) Pika e Tretë e Selimit buron nga Vendimi i Kundërshtuar;<sup>129</sup> (ii) ajo ndikon në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit;<sup>130</sup> dhe (iii) një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me të do t'i kontribuojë thelbësisht procesit.<sup>131</sup>

77. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses miraton lejen për apel në lidhje me Pikën e Tretë të Selimit.

#### 4. Pika e Katërt e Selimit

78. Mbrojtja e Selimit parashton se konstatimi i Trupit Gjykses se rregulla 90(E) e Rregullores së TPNJ-së nuk ka zbatim jashtëjuridiksional është aspekt më vete prej aspektit tjetër nëse pranimi i provave sipas asaj rregulle në një kontekst jashtëjuridiksional shkakton dëm të papërligjur.<sup>132</sup> Mbrojtja e Selimit pretendon se Pika e Katërt e Selimit ndikon drejtpërdrejt në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe në rezultatin e gjykimit, pasi ngre dyshimin se vlera provuese e provave të pranuar nga Trupi Gjykses zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.<sup>133</sup> Mbrojtja e Selimit gjithashtu argumenton se një vendim për Pikën e Katërt të Selimit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit, sepse u mundëson ZPS-së dhe Mbrojtjes që t'i paraqesin provat dhe argumentet përkatëse duke pasur njohuri të plota për provat që do t'u duhet të kundërshtojnë dhe për aspektet për të cilat do t'u duhet të paraqesin prova të mëtejshme.<sup>134</sup>

---

<sup>129</sup> *Shih më lart* para. 19, 29.

<sup>130</sup> *Shih më lart* para. 20, 30.

<sup>131</sup> *Shih më lart* para. 21, 31.

<sup>132</sup> Kërkesa e Selimit, para. 12-14, që i referohen, ndër të tjera, para. 159 të Vendimit të Kundërshtuar. *Shih gjithashtu* para. 21 të Kërkesës së Selimit.

<sup>133</sup> Kërkesa e Selimit, para. 23, 25.

<sup>134</sup> Kërkesa e Selimit, para. 26. *Shih gjithashtu* para. 27-28 të Kërkesës së Selimit.

79. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Katërt e Selimit nuk meriton leje për apel, pasi Mbrojtja e Selimit thjesht shpreh mospajtim me vlerësimin e bërë nga Trupi Gjykses se vlera provuese e provave të Selimit në TPNJ ka më shumë peshë se efekti dëmtues i tyre.<sup>135</sup>

80. Mbrojtja e Selimit kundërpërgjigjet se ZPS-ja thjesht përsërit konstatimet faktike të Trupit Gjykses; por bie në sy mungesa e përgjigjes ndaj pretendimeve konkrete të Mbrojtjes së Selimit në lidhje me secilin prej këtyre konstatimeve.<sup>136</sup>

81. Trupi Gjykses rikujton se në Vendimin e Kundërshtuar ai konstatoi se për pranimin si provë të një deklaratë dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një individ i cili në atë kohë dhe gjatë dhënies së intervistës apo dëshmisë nuk konsiderohej si i dyshuar, tërësia e paralajmërimeve që i bëhen personit të dyshuar nuk ishte parakusht ligjor.<sup>137</sup> Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se provat e z. Selimi për TPNJ-në, të dhëna në cilësinë e dëshmitarit: (i) u dhanë vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe, rrjedhimisht, u morën në një mënyrë që është në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; dhe (ii) kanë vlerë provuese e cila nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.<sup>138</sup> Pasi konstatoi se provat e z. Selimi për TPNJ-në kishin lidhje me lëndën dhe ishin autentike, Trupi Gjykses i pranoi ato si prova.<sup>139</sup> Në kundërshtim me parashtrimin e Mbrojtjes së Selimit,<sup>140</sup> Trupi Gjykses faktikisht e shqyrtoi pretendimin për efektin dëmtues të shkaktuar nga pranimi i provave të z. Selimi për TPNJ-në, gjatë dhënies së të cilave ai nuk u informua shprehimisht për të drejtën e mosinkriminimit të vetes. Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Katërt e Selimit keqinterpretonte konstatimet e Trupit Gjykses dhe përbën thjesht mospajtim me to. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Selimit nuk

---

<sup>135</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 9.

<sup>136</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 4.

<sup>137</sup> *Shih më lart* para. 19.

<sup>138</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 156, 161.

<sup>139</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 155-158, 161, 163, 221(b).

<sup>140</sup> Kërkesa e Selimit, para 13-14.

ka vërtetuar se Pika e Katërt e Selimit përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

82. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2). Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Katërt të Selimit rrëzohet.

### 5. Pika e Pestë e Selimit

83. Mbrojtja e Selimit parashton se Trupi Gjykes gaboi që nuk mori parasysh KPPK-në sa i takon deklaratave të dhëna nga një i pandehur kundër të bashkakuzuarve.<sup>141</sup> Mbrojtja e Selimit pretendon se Pika e Pestë e Selimit ka të bëjë me mungesën e gatishmërisë së Trupit Gjykes për të marrë parasysh burime ligjore relevante për ta ndihmuar në interpretim dhe mbështetjen e tij në të njëjtën kohë në burime ligjore që janë më të dëmshme për të akuzuarin, duke ndikuar kështu në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.<sup>142</sup> Mbrojtja e Selimit argumenton më tej se një vendim për Pikën e Pestë të Selimit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit, sepse u mundëson ZPS-së dhe Mbrojtjes që t'i paraqesin provat dhe argumentet përkatëse duke pasur njohuri të plota për provat që do t'u duhet të kundërshtojnë dhe për aspektet për të cilat do t'u duhet të paraqesin prova të mëtejshme.<sup>143</sup>

84. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Pestë e Selimit keqinterpreton Vendimin e Kundërshtuar, pasi Trupi Gjykes nuk e shpërfilli KPPK-në.<sup>144</sup>

---

<sup>141</sup> Kërkesa e Selimit, para. 15-18, që u referohen, ndër të tjera, para. 215-216 të Vendimit të Kundërshtuar. *Shih gjithashtu* para. 21 të Kërkesës së Selimit.

<sup>142</sup> Kërkesa e Selimit, para. 24-25.

<sup>143</sup> Kërkesa e Selimit, para. 26. *Shih gjithashtu* para. 27-28 të Kërkesës së Selimit.

<sup>144</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 10.

85. Mbrojtja e Selimit kundërpërgjigjet se ZPS-ja keqinterpreton pretendimin e paraqitur nga Mbrojtja dhe nuk jep asnjë argument në mbështetje të përpjekjes së saj për të hedhur poshtë zbatimin e parimit *lex mitior*.<sup>145</sup>

86. Trupi Gjykses rikujton se në Vendimin e Kundërshtuar ai vlerësoi se dispozitat e KPPK-së që trajtojnë pranimin si prova të deklaratave të dhëna nga një i pandehur, nuk janë pjesë e kornizës ligjore të DHS-së dhe nuk janë të zbatueshme në këtë proces.<sup>146</sup> Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se, për këtë arsye, ai konstatoi se pranimi i deklaratave të të bashkëpandehurve bëhet në bazë të rregullave dhe parimeve të përgjithshme për pranimin e provave në DHS, para së gjithash, rregullës 138(1).<sup>147</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se shqetësimi kryesor që pasqyrohet në KPPK – se fajësia e të akuzuarit nuk mund të bazohet vetëm, ose në një masë vendimtare, në deklarata të tilla – është pjesë përbërëse e sistemit të provave që zbatohet në këtë gjykatë.<sup>148</sup> Rrjedhimisht, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Selimit,<sup>149</sup> Trupi Gjykses nuk e shpërfilli KPPK-në në interpretimin e kornizës ligjore të DHS-së, por konstatoi se parimet themelore që lidhen me këtë aspekt tashmë ishin pasqyruar në të. Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Pestë e Selimit keqinterpreton konstatimet e Trupit Gjykses mbi standardet ligjore të zbatueshme për pranimin e deklaratave të të akuzuarit dhe përbën thjesht mospajtim me to. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Selimit nuk ka vërtetuar se Pika e Pestë e Selimit përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

87. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2).

---

<sup>145</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 5.

<sup>146</sup> *Shih më lart* para. 58.

<sup>147</sup> *Shih më lart* para. 58.

<sup>148</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 215.

<sup>149</sup> Kërkesa e Selimit, para. 18.

Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Pestë të Selimit rrëzohet.

## 6. Pika e Gjashtë e Selimit

88. Mbrojtja e Selimit parashtron se mundësia që Mbrojtja të kundërshtojë provat, ose që Trupi Gjykses t'i vlerësojë ato në kuadrin e tërësisë së provave të paraqitura, nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e efektit dëmtues në bazë të rregullës 138(1).<sup>150</sup> Mbrojtja e Selimit pretendon se Pika e Gjashtë e Selimit ndikon drejtpërdrejt në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe në rezultatin e gjykimit, pasi ngre dyshimin se vlera provuese e provave të pranuar nga Trupi Gjykses zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.<sup>151</sup> Mbrojtja e Selimit argumenton më tej se një vendim për Pikën e Gjashtë të Selimit do t'i kontribuojë thelbësisht procesit, sepse u mundëson ZPS-së dhe Mbrojtjes që t'i paraqesin provat dhe argumentet përkatëse duke pasur njohuri të plota për provat që do t'u duhet të kundërshtojnë dhe për aspektet për të cilat do t'u duhet të paraqesin prova të mëtejshme.<sup>152</sup>

89. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Gjashtë e Selimit nuk meriton leje për apel, sepse aftësinë e z. Selimi për të kundërshtuar provat Trupi Gjykses nuk e trajtoi si zëvendësues të vlerësimit të efektit dëmtues, por si një ndër faktorët që Trupi Gjykses e mori parasysh kur konstatoi se vlera provuese e provave nuk zhbëhej prej efektit dëmtues të tyre.<sup>153</sup>

90. Mbrojtja e Selimit kundërpërgjigjet se argumentet e ZPS-së tregojnë se ajo nuk e ka kuptuar plotësisht argumentin e propozuar nga Mbrojtja në këtë pikë dhe/ose se ajo i atribuon Vendimit pjesë që nuk ai i përmban.<sup>154</sup>

---

<sup>150</sup> Kërkesa e Selimit, para. 19-20, që u referohen paragrafëve 88, 141, 144, 161 të Vendimit të Kundërshtuar. *Shih gjithashtu* para. 21 të Kërkesës së Selimit.

<sup>151</sup> Kërkesa e Selimit, para. 23, 25.

<sup>152</sup> Kërkesa e Selimit, para. 26. *Shih gjithashtu* para. 27-28 të Kërkesës së Selimit.

<sup>153</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 11.

<sup>154</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 6.

91. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi, ndër të tjera, se vlera provuese e deklaratave të të akuzuarit nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.<sup>155</sup> Trupi Gjykses e mbështeti këtë konstatim në tre faktorë kryesorë: (i) Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë cilindo aspekt të deklaratave të të akuzuarit në rast se ZPS-ja ia paraqet ato një apo më shumë dëshmitarëve gjatë gjykimit; (ii) Mbrojtja mund të thërrasë dëshmitarë në gjykim për të kundërshtuar cilindo aspekt të deklaratave të të akuzuarit; dhe (iii) Trupi Gjykses do t'i vlerësojë deklaratat duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të pranuar në gjykim.<sup>156</sup> Pasi konstatoi se deklaratat e të akuzuarit ishin gjithashtu relevante, autentike, me vlerë provuese, Trupi Gjykses i pranoi ato si prova.<sup>157</sup> Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Selimit,<sup>158</sup> Trupi Gjykses nuk u mbështet në këta faktorë si alternativë ndaj vlerësimit të kriterëve të pranimit të tyre, por si pjesë e vlerësimit të vlerës provuese dhe efektit dëmtues të pranimit të këtyre deklaratave në përputhje me rregullën 138(1). Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Gjashtë e Selimit keqinterpreton konstatimet e Trupit Gjykses dhe përbën thjesht mospajtim me to. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Selimit nuk ka vërtetuar se Pika e Gjashtë e Selimit përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

92. Bazuar në sa më lart, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2). Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apel në lidhje me Pikën e Gjashtë të Selimit rrëzohet.

---

<sup>155</sup> *Shih p.sh.* para. 88, 141, 144, 161 të Vendimit të Kundërshtuar

<sup>156</sup> *Shih p.sh.* para. 88, 141, 144, 161 të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>157</sup> *Shih p.sh.* para. 87-88, 90 140-142, 143-145, 158, 161, 163, 221(b) të Vendimit të Kundërshtuar.

<sup>158</sup> Kërkesa e Selimit, para. 19.

## V. KLASIFIKIMI

93. Trupi Gjykses thekson se Kundërpërgjigjja e Veselit u dorëzua si konfidenciale. Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Veselit që deri të premtën, 12 janar 2023, të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kundërpërgjigjes së Veselit ose të kërkojë riklasifikimin e saj.

## VI. VENDIM

94. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** lejen për apel për: (i) Pikën e Parë, Pikën e Tretë dhe Pikën e Nëntë të Krasniqit; dhe (ii) Pikën e Tretë të Selimit
- b) **REFUZON** lejen për apel për: (i) Pikën e Dytë, Pikën e Katërt, Pikën e Pestë, Pikën e Gjashtë, Pikën e Shtatë dhe Pikën e Tetë të Krasniqit; (ii) Pikave të Veselit; dhe (iii) Pikën e Parë, Pikën e Dytë, Pikën e Katërt, Pikën e Pestë dhe Pikën e Gjashtë të Selimit; dhe
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen e Veselit që deri të premtën 12 janar 2023, të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kundërpërgjigjes së Veselit ose të kërkojë riklasifikimin e saj.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**  
**Kryegjykatës**

E martë, 19 dhjetor 2023

Në Hagë, Holandë.